



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
AGJENCIA PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI
AGENCIJA ZA INFORMACIJE I PRIVATNOST
INFORMATION AND PRIVACY AGENCY



Nr. 253 /2024
Datë: 04.11.2024

Agjencia për Informim dhe Privatësi, Zyrtari i Inspektimit, duke vepruar në pajtim me nenin 68, nenin 69, paragrafi 1 dhe nenin 71, paragrafi 1, nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nenin 13, paragrafi 3, nënparagrafi 3.2 të Rregullores Nr. 04/2022 për Procedurën e Brendshme për Shqyrtimin e Ankesave për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pas shqyrtimit të ankesës me numër protokollit 453, të datës 06.06.2024, të parashtruar nga subjekti i të dhënave z. A.A, ndaj kontrolluesit Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës - Konsullata e Përgjithshme e Kosovës në Frankfurt nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **Aprovohet** pjesërisht e bazuar ankesa me numër të protokollit 453, e datës 06.06.2024, e parashtruar nga subjekti i të dhënave personale, ndaj kontrolluesit Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës - Konsullata e Përgjithshme e Kosovës në Frankfurt.
2. **Këshillohet** Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës - Konsullata e Përgjithshme e Kosovës në Frankfurt (në cilësinë e kontrolluesi), që përpunimin e të dhënave personale përmes sistemit të vëzhgimit me kamerë ta bëjë në harmoni me dispozitat ligjore të përcaktuara me nenin 76, të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
3. **Obligohet** kontrolluesi, që nga data e pranimi të këtij vendimi, të ndërmerr të gjitha veprimet e duhura për zbatim të këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Agjencia për Informim dhe Privatësi (Agjencia), më datë 06.06.2024, ka pranuar një ankesë e parashtruar nga subjekti i të dhënave, e cila mbanë numrin e protokollit 453. Në ankesën e tij subjekti i të dhënave ka shpjeguar se, në Konsullatën e Përgjithshme të Kosovës në Frankfurt,

është e vendosur sistemi i vëzhgimit me kamerë, përmes së cilit bëhet monitorimi i punëtorëve për vijueshmërinë në punë si dhe gjithashtu monitorohet çdo palë brenda Konsullatës. Gjithashtu pala ankuese ka përshkruar se ruajtja e të dhënave të marra nga kamerat bëhet nga telefoni personal i Konsullit. Njëheri pala ankuese pretendon se rreziku që paraqitet nga përpunimi i të dhënave biometrike të punonjësve dhe palëve përmes sistemit të vëzhgimit, paraqet një neglizhencë në vlerësimin e ndikimit mbi mbrojtjen e të dhënave personale. Ankuesi ka bashkangjitur si dëshmi provën e e-mailit të pranuar më datë 30.05.2024, nga Konsulli i Përgjithshëm në të cilën e-mail është përshkruar si: ” *Të gjitha vonesat e cekura janë të faturuara me foto dhe video* ”.

Bazuar në nenin 68, paragrafi 1, dhe nenin 69, të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (LMDhP), Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP), përmes zyrtarëve të inspektimit, ka filluar shqyrtimin e ankesës për të vërtetuar pretendimet e palës ankuese. Si fillim, zyrtari i inspektimit më datë 16.09.2024, përmes postës elektronike iu është drejtuar me një shkresë, zyrtari për mbrojtjen e të dhënave personale si pikë kontakti në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD) e cila është përgjegjëse për Konsullatën e Përgjithshme të Kosovës në Frankfurt, të cilin e ka njoftuar me ankesën si dhe nga i njëjti ka kërkuar ta njoftojë Agjencinë, lidhur me pretendimet e palës ankuese dhe njëkohësisht, të na njoftojë me ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale përmes sistemit të vëzhgimit me kamerë.

Më datën 19.09.2024, Agjencia ka pranuar nga ZMDHP-ja, një përgjigje, ku ka shpjeguar si në vijim: *“Për informacionin tuaj, personi ankimues ishte zyrtar nga stafi teknik i KP, i cili krahas vërejtjeve për moskryerje të detyrave të punës ishte paralajmëruar edhe për vonesat e shpeshta në punë. Pas skadimit të kontratës provuese, ai nuk është më pjesë e stafit të këtij misioni. Një nga shkeljet e tij në punë ishin vonesat e shpeshta, por kamerat e sigurisë nuk janë përdorur si argumente për të deshmuar për një gjë të tillë. Për me tepër, unë nuk kam qasje në kamera përmes telefonit personal. Qasja në kamera është e instaluar vetëm nga PC-ja zyrtare të cilën e kam në përdorim në vendin e punës në konsullatë. Kamerat janë vendosur në vitin 2022, pas kalimit në objektin e ri.*

Vetëm një person brenda Konsullatës së Përgjithshme në Frankfurt, ka qasje në sistemin e kamerave. PC-ja ku ndodhet software i kamerave administrohet nga MPJD dhe është në përdorim vetëm nga Udhëheqësi i Konsullatës së Përgjithshme në Frankfurt.

Aktualisht afati i ruajtjes së regjistrimeve është 17 ditë.

Personat që punojnë janë shumë mirë të njoftuar por edhe palët që vijnë nga jashtë janë të mirë informuar për vendosjen e kamerave brenda ambienteve të konsullatës. Shënjimi me fotografi për vendosjen e kamerave është i vendosur në pjesën e jashtme të derës së hyrjes në konsullatë, si dhe në pjesën e brendshme ballore sapo palët të hyjnë brenda në konsullatë.

Kamerat nuk janë të vendosura në zyrat ku qëndrojnë zyrtaret. Ato janë vendosura vetëm në korridore dhe në sallën ku qëndrojnë palët. Vetëm njëra prej kamerave është e vendosur sipër, brenda zyrës së shërbimeve. Ajo e ka këndin shumë të ngushtë të vëzhgimit pra rreth 50cm, me qëllim që ta përfshijë deskun e pagesave. Për këtë janë të informuar zyrtarët që gjatë asaj kohe sa kryejnë pagesa, aparati i pagesave monitorohet sipër nga kamera e sigurisë”.

Së bashku me përgjigjen e pranuar, kontrolluesi ka bashkëlidhur edhe vendimin e nxjerrë për vendosjen e kamerave, kopja e planit që tregon ndarjen e hapësirave dhe fotografitë ku janë të vendosura kamerat.”

Pas pranimit të përgjigjes së pranuar nga kontrolluesi, zyrtari i inspektimit me qëllim të një pasqyre më të qartë, për të parë se çfarë perimetri të vëzhgimit kapin këto kamera dhe se a rrezikohen të drejtat e punëtoreve, ka kërkuar nga i njëjti të na dërgojë pamjet nga ekranit i kamerave. Po në të njëjtën datë, nga i njëjti kemi pranuar fotografit nga pamjet e ekranit të kamerave.

Bazuar në fotografitë e pranuar nga kontrolluesi, në objektin e Konsullatës së Kosovës në Frankfurt, janë të vendosura gjithsej katër (4) kamera. Kamera e vendosur në hyrje të Konsullatës përfshinë pamje të hyrjes dhe të korridorit. Kamera e vendosur në sallën e pritjes tek sporteli përfshinë vetëm pamjet të palave në pjesën e pritjes. Kamera e vendosur në sallën e madhe përfshinë pamje të sallës dhe pjesën e korridorit të hyrjes në Konsullatë si dhe kamera e cila është e vendosur brenda sportelit përfshinë pamjen vetëm të tavolinës në sportel ku bëhen pagesat. Me qëllim të verifikimit të përgjigjes së pranuar nga kontrolluesi, në të cilën ka deklaruar se, PC-ja ku ndodhet software i kamerave administrohet nga MPJD, zyrtari inspektim i TI, ka realizuar inspektim në MPJD. Gjatë inspektimit është konstatuar se qasja në softwerin e sistemit të vëzhgimit me kamerë mundësohet kyçja vetëm nga kompjuteri i punës të Konsullit të Përgjithshëm në Frankfurt, ku llogaria zyrtare përmes të cilës kyçet në domain nuk mundëson kthimin, kontrollin apo editimin e pamjeve përpos shikimin në kohë reale, që do të thotë se Konsulli i Përgjithshëm kyçet vetëm si përdorues i thjeshtë. Softueri i kamerave mund të kontrollohet përmes llogarisë së administrimit përmes remote desktop nga administratori i TI-së në MPJD, nga e cila mund të konfigurohet dhe të jepet atributi për përdorues. Lloji i kamerave është LUPUS si dhe softueri është i prodhuesit.

LMDhP në nenin 3, paragrafi 1, nën paragrafi 1.11, ka dhënë përkufizimi i shprehjes ‘kontrollues i të dhënave’, me të cilin nënkuptohet se kontrollues i të dhënave është çdo person fizik apo juridik nga sektori publik ose privat që individualisht ose së bashku me të tjerët përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale. Andaj, sipas këtij përkufizimi, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës - Konsullata e Përgjithshme e Kosovës në Frankfurt, cilësohet kontrollues i të dhënave.

LMDhP, përcakton të drejtat, përgjegjësitë, parimet dhe masat ndëshkuese lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë së individit. Sipas nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të LMDHP-së, me të dhëna personale nënkuptojmë çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm, një person fizik i identifikueshëm është ai, i cili, mund të identifikohet drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, veçanërisht duke iu referuar një identifikuesi në bazë të një emri, një numri identifikimi, të dhënave rreth vendndodhjes, një identifikues online, ose një apo më shumë faktorë specifikë për identitetin fizik, psikologjik, gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose social të atij personi fizik.

Në kontekstin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë së individit, vëzhgimi me kamerë nënkupton marrjen dhe ruajtjen e të dhënave vizuale ose të tjera nga vendet e vëzhguara, ku personat fizikë lëvizin apo edhe qëndrojnë.

Për më tepër, vëzhgimi me kamerë nënkupton përpunimin e të dhënave personale gjatë regjistrimit të një personi fizik, në përputhje me përkufizimin e përpunimit të të dhënave

personale të parashikuara në LMDhP. Kur kemi të bëjmë me përpunimin e të dhënave personale, LMDhP në dispozitat e tij ka dhënë kuptimin se cilat veprime konsiderohen si përpunim i të dhënave personale, gjegjësisht neni 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të LMDhP-së, përcakton se me përpunim nënkuptojmë çdo veprim ose seri veprimesh që kryhen ndaj të dhënave personale me mjete automatike ose jo, si: mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, tërheqja, konsultimi, përdorimi, publikimi nëpërmjet transmetimit, shpërndarja ose ofrimi, njësimi ose kombinimi, kufizimi, fshirja ose asgjësimi. Në kuadër të kësaj dispozite, nënkuptojmë se mbledhja dhe regjistrimi i imazheve të marra nga sistemi i vëzhgimit me kamerë, përbënë përpunim të të dhënave personale dhe si i tillë, ky përpunim duhet të bëhet në mënyrë të ligjshëm dhe në harmoni me kreun XVI të LMDHP-së.

Neni 75, paragrafi 2, i LMDhP-së, ka përcaktuar se, personat në sektorin publik ose privat që kanë për qëllim të instalojnë sistemet e vëzhgimit me kamerë duhet të vendosin njoftimin për këtë. Organet publike ndërmarrin masat e përshtatshme për të identifikuar kontrolluesin. Njoftimi i tillë duhet të jetë i dukshëm dhe të bëhet publik në mënyrë që t'iu mundësojë subjekteve të të dhënave, që pa vështirësi, të njoftohen me masat, më së voni kur të fillojë vëzhgimi me kamerë. Bazuar në këtë dispozitë kontrolluesi i të dhënave ka të vendosur shenjë njoftuese lidhur me aplikimin e vëzhgimit me kamerë në ndërtesën e Konsullatës.

Neni 76, i LMDhP-së, ka përcaktuar dispozitat ligjore të cilat duhet respektuar me rastin e vëzhgimit të ndërtesave zyrtare dhe të bizneseve. Sipas këtyre dispozitave personat në sektorin publik dhe privat mund të instalojnë sistemin e vëzhgimit me kamerë për vëzhgimin e ndërtesave të tyre nëse konsiderohet e nevojshme për sigurinë e njerëzve dhe sigurinë e pasurisë. Vëzhgimi me kamerë, në veçanti, mund të jetë i nevojshëm për të vëzhguar hyrjet e ndërtesave ose ku për shkak të natyrës së punës së tyre, ekziston kërcënimi potencial ndaj të punësuarve.

Në këndvështrim të këtyre dispozitave të LMDhP-së, kontrolluesi mund të vendos sistemin e vëzhgimit me kamerë në ato hapësira ku është e nevojshme për sigurinë e njerëzve dhe pronës, duke plotësuar kushtet e parapara me këto dispozita

Gjithashtu, në këto dispozita është paraparë se, për instalimin e sistemit të vëzhgimit me kamerë, duhet merret vendim nga nëpunësi kompetent, drejtori ose ndonjë person tjetër i autorizuar nga sektori privat, i cili vendim duhet të përmbajë arsyet për vendosjen e sistemit të vëzhgimit me kamerë.

Bazuar në këtë dispozita, kontrolluesi ka bashkangjitur vendimi i nxjerrë më datë më datë 08 07.2022, në të cilin është përcaktuar qëllimi i vendosjes së sistemit, ku sistemi i vëzhgimit me kamerë bëhet me qëllim të sigurisë së ambientit të brendshëm të konsullatës, ashtu siç është paraparë me dispozita ligjore të cilat përcaktojnë se vëzhgimi me kamerë mund të instalohej për të vëzhguar ndërtesën me qëllim të sigurisë së pronës dhe të njerëzve.

Në rastin konkret, edhe pse kontrolluesi ka deklaruar se sistemi i vëzhgimit me kamerë nuk është përdorur si argumente për të deshmuar vijueshmëria e punonjësve, bazuar në dëshminë e pranuar nga subjekti i të dhënave, konsiderohet se kontrolluesi në një masë ka përdorur sistemin e vëzhgimit si dëshmi për ti vërtetuar subjektit të të dhënave pretendimet e tij.

Nëse përdorimi i sistemit të vëzhgimit me kamerë është arsyetuar për një qëllim të caktuar, si siguria, ai nuk duhet të përdoret për një qëllim të mëtejshëm, siç është monitorimi i frekuentimit, hyrje daljeve në punë ose performancës së stafit. Megjithatë, mund të lindin

situata kur një punëdhënës duhet të përdorë pamjet e sistemit të vëzhgimit me kamerë për një qëllim të ndryshëm nga ai i identifikuar në fillim, si për të hetuar një pretendim për sjellje të pahijshme ose çështje të tjera disiplinore.

Një nga qëllimet legjitime mund të jetë kur lindin situata kur një punëdhënës duhet të përdorë pamjet e sistemit të vëzhgimit me kamerë për një qëllim të ndryshëm nga ai i identifikuar në fillim, si për të hetuar një pretendim për sjellje të pahijshme ose çështje të tjera disiplinore. Kjo mund të jetë legjitime kur kryhet rreptësisht, rast pas rasti dhe arsyetohet bazuar në domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin për të arritur qëllimin e caktuar. Punëdhënësi duhet të jetë në gjendje të demonstrojë se pse përdorimi i sistemit të vëzhgimit me kamerë është i nevojshëm për të siguruar prova në një çështje disiplinore, dhe se qasja e tyre në pamjet e sistemit të vëzhgimit me kamerë është proporcional dhe i kufizuar në fushëveprimin për hetimin e një çështjeje të caktuar. Në raste të tilla, të drejtat e punonjësit dhe pritshmëria e tij për privatësinë nuk do të shihen si mbizotëruese të interesave të punëdhënësit dhe mbrojtjes së të dhënave të punonjësit. Andaj nga kjo që u tha më lartë, përpunimi i të dhënave personale përmes sistemit të vëzhgimit me kamerë mund të bëhet vetëm nga ana komisioni disiplinor, për të vërtetuar pretendimet e ngritura nga punëdhënësi ndaj punëtorit dhe në këtë mënyrë e përpunimit të të dhënave përmes sistemit të vëzhgimit me kamerë nuk bie ndesh me LMDhP-në.

Në dispozitat e nenit 76, të LMDhP-së, është përcaktuar edhe afati i ruajtës së regjistrimeve nga sistemet e vëzhgimit me kamerë, të cilat regjistrime mund të ruhen deri në një (1) muaj përveç nëse nuk kërkohet ndryshe për qëllime legjitime.

Bazuar në përgjigjen e kontrolluesit, ku regjistrimet nga sistemet e vëzhgimit me kamerë ruhen vetëm shtatëmbëdhjetë ditë, që nënkupton se pas kësaj dite këto regjistrime fshihen automatikisht, konsiderohet se ruajtja e regjistrimeve nga sistemit i vëzhgimit me kamerë nga kontrolluesi bëhet brenda afatit të përcaktuar me dispozita ligjore.

Neni 35, i LMDhP-së, ka përcaktuar se, nëse një tip i përpunimit, veçanërisht përdorimi i teknologjisë së re dhe duke marrë parasysh natyrën, objektin, kontekstin dhe qëllimet e përpunimit, mund të rezultojë në një rrezik të lartë për të drejtat dhe liritë e personave fizikë, kontrolluesi, para përpunimit, kryhen një vlerësim të ndikimit të operacioneve të parashikuara të përpunimit mbi përpunimin e të dhënave personale. Vlerësimi i ndikimit mbi mbrojtjen e të dhënave kërkohet veçanërisht në rastin e monitorimit sistematik të një zone me qasje publike me shkallë të gjerë.

Në kuptim të kësaj dispozite, monitorimi përmes sistemit të vëzhgimit me kamerë në rastin konkret nuk bëhet në një zonë me qasje publike në shkallë të gjerë, andaj dhe vlerësimi i ndikimit të mbi përpunimin e të dhënave personale nuk është i obliguar të bëhet. Gjithashtu kontrolluesi ka deklaruar se mbikqyrja e kamerave nuk bëhet nga telefoni personal i tij por qasja në kamera është e instaluar vetëm nga PC-ja zyrtare të cilën e ka në përdorim në vendin e punës në konsullatë. Njëheri, përmes sistemit të vëzhgimit me kamerë nuk bëhet përpunimi i të dhënave biometrike.

Andaj, nga e gjithë kjo që u tha më sipër, bazuar në ankesën e subjektit të të dhënave me dëshmitë e bashkangjitura, përgjigjen e kontrolluesit si dhe inspektimin e realizuar nga zyrtari i inspektimit të TI, Agjencia konsideron, përpunimin e të dhënave personale përmes sistemit të vëzhgimit me kamerë nga kontrolluesi është bërë pjesërisht në kundërshtim me nenin 76, të LMDhP-së.

Agjencia për Informim dhe Privatësi pas shqyrtimit të ankesës, përgjigjes së pranuar nga kontrolluesi dhe inspektimit të realizuar, bazuar në kompetencat e dhëna me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

[Nënshkruar më datë 04.11.2024]

Zyrtare e Inspektimit

Këshillë Juridike

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa. Pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej 30 ditësh. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Kontrolluesit -Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës - Konsullata e Përgjithshme e Kosovës në Frankfurt,
- Ankuesit,
- Arkivit të Agjencisë.